

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE 2025

Nr. rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesë	Tarifa
1	07.01.2025	Te nderuar, Kam perfunduar studimet si gjimnaziste e shkelqyer, si dhe jam dekoruar nga Kryeministri dhe Ministria e Arsimit. Ne kushtet kur pershkak te padijenise jam paraqitur dhe kam kerkuar informacion ne lidhje me afatet dhe proceduren per te perfituar burse sa paga minimale, jam informuar se kane perfunduar afatet per aplikim.Une jam paraqitur ne institucionet perkatese,por per shkak te keqinformimit ne shkolle,nuk me eshte dhene mundesia per dorezimin e dokumentacionit perkates. Une ndjek studimet ne programin "Mjekesi e Pergjithshme", ne Univeritetin e Mjekesise,Tirane. Ju lutem,ne kushtet kur une plotesoj te gjitha kriteret per tu trajtuar me burse si studente e shkelqyer,te gjehet nje zgjidhje ligjore ne menyre qe te mos kufizohem nga e drejta per te perfituar dhe une. Ju lutem merrni ne konsiderate qe te me ofrohet mundesia per te aplikuar dhe mua. Faleminderit per mirekuptimin!	10.01.2025	Përshendetje, Ju keni aplikuar për përfitimin e mbështetjes financiare si student I shkëlqyer në programin e studimit “ Mjekësi e Përgjithshme” në Universitetin e Mjekësisë Tiranë, pranë AKFAL më datë 18.10.2024 , me aplikimin nr.xxx Ju do të njoftoheni pas përfundimit të procesit administrativ për procedurat që do të ndiqni. Faleminderit,	Pergjigjia jepet e plote	JO
2	09.01.2025	Po ju shkruaj per te kerkuar disa informacione lidhur me bursen e ekselences sa paga minimale. Do te doja te dija ne qofte se do te kete me mundesi te aplikojne ata studente te cilet nuk jane informuar me pare ne lidhje me datat e fillimit dhe perfundimit te aplikimeve. Ju falenderoj paraprakisht!	31.01.2025	Përshendetje, Në vijim të ankesës tuaj nëpërmjet së cilës keni parashtruar se përshkak të mungesës së informacionit, ju nuk keni mundur të aplikoni brenda afatit të përcaktuar në shpalljen e AKFAL për mbështetje financiare sipas pikës 2/a të VKM nr.386/2022, i ndryshuar, ju informojmë se: Sipas nenit 54, të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, pala mund të kërkojë rivendosjen në afat, nëse është penguar për shkaqe të arsyeshme për respektimin e afatit procedural. Rivendosja në afat mund të kërkohet për afatet e përcaktuara për paraqitjen e kërkesës fillestare. Sa më sipër, lutemi nga ana juaj në rast se vijoni të keni interes të ligjshëm për të përfituar nga format e parashikuara në ligj për përmirësimin e statusit socio-ekonomik të studentëve të na dërgoni në adresën e emailit info.akfal@arsimi.gov.al: kërkesën për rivendosje në afat të aplikimit për mbështetje studentore; dokument identifikimi (fotokopje); diploma dhe certifikata e maturës shtetërore; formularin e aplikimit. Bashkëlidhur ju përcjellim modelin e formularit të aplikimit dhe të kërkesës për rivendosje në afat. Faleminderit,"	Pergjigjia jepet e plote	JO
3	09.01.2025	Përshëndetje! Kam dërguar pranë AKFAL kërkesë për trajtim financiar si ekselente. Jam e interesuar se çfarë procedure do të ndjekim për të marrë pagën. Me konsideratë, studentja e mjekësisë.	10.01.2025	Kthim përgjigje Përshendetje, Ju keni aplikuar për përfitimin e mbështetjes financiare si student I shkëlqyer në programin e studimit “ Mjekësi e Përgjithshme” në Universitetin e Mjekësisë Tiranë, pranë AKFAL më datë 18.10.2024 , me aplikimin nr.279/23. Ju do të njoftoheni pas përfundimit të procesit administrativ për procedurat që do të ndiqni. Faleminderit,	Pergjigjia jepet e plote	JO

4	14.01.2025	Përschëndetje! Ju lutem pranoi dosjen e djalit tim sepse kam bere ankese te portali bashkëqeverisjes dhe me thanë që po ndjekin chështjen dhe t ju nisja dokumentat per përfitim financiar.	31.01.2025	Pershendetje, Në mbështetje të VKM nr.386/2022, i ndryshuar, pika 2 “Mbështetjen financiare nga buxheti i shtetit ose të ardhura të tjera të ligjshme, të studentëve shtetas shqiptarë të pranuar në institucionet publike të arsimit të lartë, që nuk janë njëkohësisht përfshues të ndonjë financimi tjetër nga shteti shqiptar dhe që plotësojnë kriteret e mëposhtme: a) Studenti me notë mesatare në pranim, që: i. ka përfunduar arsimin e mesëm të lartë me notë mesatare 10.00; ii. në secilin prej provimeve kombëtare të detyruara të maturës shtetërore është vlerësuar me jo më pak se nota e shkallëzuar 9.5 deri në 10.00. b) Studenti fitues i njërit prej tri çmimeve të para në olimpiadat ndërkombëtare të arsimit parauniversitar, me më shumë se 15 vende pjesëmarrëse, pavarësisht notës mesatare, kur pranohet në programe studimi, që lidhen me lëndën/t/disiplinën ku ka fituar çmimin; c)) Studenti, i cili ka zgjedhur të ndjekë një prej programeve të studimit, që përbën prioritet kombëtar, të përcaktuara nga komisioni ad hoc, i ngritur pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin, për çdo vit akademik, sipas fushave të studimit të miratuara në shtojcën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi”. Referuar edhe pikës 6/1 të VKM nr.386/2022, i ndryshuar, për përcaktimin e programeve prioritare të studimit dhe kuotave të financimit për këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë për studentët përfshues sipas shkronjës “c”, të pikës 2, të këtij vendimi, për çdo vit akademik, ngrihet komision ad hoc. Komisioni ad hoc përcakton, sipas fushave të përcaktuara në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi, programet prioritare të studimit në institucionet publike të arsimit të lartë.	Pergjigjia jepet e plote	Jo
5	04.02.205	Pershendetje, me kete email doja te informohesha mbi kreditë studentore se si funksionojne, ku aplikohet dhe si realizohet shlyerja e kredise. Pres pergjigjen tuaj. Faleminderit.	06.02.2025	Përschëndetje, Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion ju bëjmë me dije se: Ajencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë ka hapur aplikimet për Kredi Studentore. Studentët mund të aplikojnë brenda muajit Shkurt, nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”, në shërbimi elektronik "Aplikim për Kredi Studentore", duke plotësuar formularin e aplikimit dhe duke ngarkuar dokumentet e nevojshme.	Pergjigjia jepet e plote	Jo
6	21.02.2025	Pershendetje, si jeni desha me shum info rreth kredise studentore ! Sa eshte shuma minimale dhe maksimale qe lejohet te merret per kredine e studenteve ! App esjte me kriterë! Mund te ma shpjegoni me detaje ju lutem !!!!	25.02.2025	Pershendetje, Ne pergjigje te emailit te nepositem ju informoj se: Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 440, datë 19.07.2023, “Për përcaktimin e skemës së Kreditimit Studentor”, i ndryshuar, studentët me shtetësi dhe vendbanim në shqipëri, që janë të regjistruar dhe ndjekin studimet në një institucion të arsimit të lartë publik, të cilët nuk janë subjekt përfitimi prej akteve që mbështesin studentin me bursa,mbështetje financiare apo përjashtim nga tarifa, ka te drejte te aplikojne per kredi studentore, nepermjet portalit unik qeveritar “e-Albania”, brenda muajit shkurt. Sipas skemës së kreditimit studentor, studentët të cilët plotësojnë kushtet e përcaktuara në VKM 440/2023, i ndryshuar, kanë të drejtë të paraqesin kërkesë për kredi studentore, për financimin e kostove të studimeve. Kostoja e studimeve përfshin, tarifën e studimeve dhe kostot e jetesës e cila përfshihet deri në kufirin e pagës minimale në shkallë vendi, të përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, në masën 40.000 lekë/muaj. Shenblli (Tarifa e studimit) ____ lek/vit x ____ lek/vit studimi = ____ lek plus Kostot e jetesës ____ lek/muaj x ____ muaj = ____ lek) ose (Tarifë Studimi + Kosto e jetesës). Kreditimi i studentëve do të realizohet nga banka e nivelit të dytë, e cila përzgjidhet fituese për të lidhur kontratë me studentët përfshues. Një pjesë e normës së interesit të kredisë (jo më shumë se pesë pikë përqindje) do të financohet nga buxheti i shtetit nga fondit për arsimin e lartë. Rendija e aplikimeve të studentëve për kredi studentore bëhet duke u bazuar në kushtet e përcaktuara në pikën 7, të VKM-së nr 440/2023, i ndryshuar, të listuara si më poshtë: Vlera e kredisë së kërkuar; Lloji i programit të studimit ku është regjistruar studenti; Rezultatet e studentit kërkuar për kredi studentore. Pas shpalljes së renditjes së kërkesave për kredi studentore, AKFAL informon studentët për vijimin e procedurave dhe lidhjen e kontratës së kredisë me bankën përkatëse. Duke ju falenderuar,	Pergjigjia jepet e plote	Jo

7	23.02.2025	Pershendetje si jeni?Doja t'iu pyesja ne lidhje me kredine studentore .Doja te dija se ku mund te gjejmë dokumentin qe studenti nuk perfiton ndihme financiare?	25.02.2025	Pershendetje, Ne pergjigje te emailit te tuaj ju informoj se: Ne mbeshtetje te Vendimit nr.440 date 19.7.2023 "Per percaktimin e Skemes se Kreditimit Studentor", studenti i cili nuk eshte subjekt perfitimi prej akteve qe mbeshtesin studentin me bursa,mbeshtetje financiare apo perjashtim nga tarifa, ka te drejte te aplikojne per kredi studentore ne sherbimin "Aplikim per kredi studentore", nepermjet portalit unik qeveritar "e-Albania", brenda muajit shkurt. Dokumenti "Vertetim qe studenti nuk eshte perfitues i mbeshtetes financiare, burse apo perjashtim nga tarifa e studimit", leshohet prane Universitetit/ Fakultetit ku ju ndiqni studimet. Mbetemi te hapur per cdo kerkese per informacion. Ju faleminderit,	Pergjigjia jepet e plote	Jo
8	24.02.2025	Pershendetje, Kam marre emailin e meposhtem prej jush qe ne nenor. Deshta me konfirmu a perfitoj bursen apo asht nis gabimisht?	24.02.2025	Pershendetje, Në zbatim të pikës 10, të Udhëzimit të MAS nr.30, datë 04.11.2022 “Për percaktimin e rregullave dhe afateve të aplikimit, si dhe të procedurave të percaktimit të masës dhe mënyrës së financimit të studentëve të shkëlqyer dhe atyre që ndjekin programe studimi që përbëjnë prioritet kombëtar”, të ndryshuar, ju jeni njoftuar ne rruge zyrtare mbi vijueshmerine e mbeshtetes financiare per vitin akademik 2024-2025. Gjithashtu ju konfirmojme se znj.XXX qe ndjek studimet ne programin "Turizëm", Universiteti , ka plotësuar kriteret për vijimin e financimit të percaktuara, dhe eshte miratuar si studente që do të përfitojë mbështetje financiare edhe për vitin akademik 2024-2025. Duke ju falenderuar,	Pergjigjia jepet e plote	Jo
9	24.02.2025	Pershendetje, Se pari faleminderit per konfirmimin si dhe deshta te pyes per pagesen e mandatit te universitetit. Une nuk e kam paguar akoma, a duhet ta paguaj? Faleminderit,	25.02.2025	Pershendetje, Ne pergjigje te emailit te meposhtem ju informoj se ne zbatim te pikes 1 te nenit 3 te marreveshjes trepaleshe "Per perfitimin e Mbeshtetes Financiare", studenti përfitues i mbeshtetes financiare përjashtohet nga pagesa e tarifës vjetore të shkollimit dhe financohet në nivelin e pagës minimale në shkallë vendi. Duke ju falenderuar,	Pergjigjia jepet e plote	Jo
10	25.02.2025	Pershendetje! Shpresoj të jem duke ju gjetur mirë. Unë jam studente vitit të dytë pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër. Në vitin e parë akademik kam përfituar bursën e plotë për degët prioritare, dhe këtë vit kam dorëzuar formularin e aplikimit për vazhdimin e bursës, sipas procedurave të percaktuara. Megjithatë, deri më tani nuk kam marrë asnjë përgjigje në lidhje me statusin e aplikimit tim. Gjithashtu, kam kërkuar informacion pranë Rektoratit të Universitetit, por nuk kam marrë sqarime të mjaftueshme mbi këtë çështje. Për këtë arsye, ju lutem të më informoni mbi ecurinë e aplikimit tim dhe nëse kërkohet ndonjë veprim shtesë nga ana ime për përfundimin e procesit. Çdo informacion mbi këtë çështje do të ishte shumë i vlefshëm për mua.Sepse akoma nuk kam paguar tarifen e shkolles dhe edhe 2 dit eshte afati . Ju falënderoj për kohën dhe ndihmën tuaj. Pres me interes përgjigjen tuaj. Me respekt,	26.02.2025	Përsërdetje, Në përgjigje të emailit tuaj ju informojmë se: Në mbështetje të VKM Nr. 386, Datë 1.6.2022 “Për miratimin e fashave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e të studentëve, që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë”, i ndryshuar, të Udhëzimit Nr. 30, datë 4.11.2022 “Për percaktimin e rregullave dhe afateve të aplikimit, si dhe të procedurave të percaktimit të masës dhe mënyrës së financimit të studentëve të shkëlqyer dhe atyre që ndjekin programe studimi që përbëjnë prioritet kombëtar” i ndryshuar, si dhe të marrëveshjes trepalëshe të nënshkruar nga ju, jeni njoftuar në adresën elektronike mbi dorëzimin e dokumentacionit, mbi plotësimin e kriterëve për të vijuar mbështetjen financiare edhe për vitin akademik 2024-2025. Në përfundim të procesit të verifikimit të plotësimit të kërkesave me qëllim vijimin e financimit ju jeni njoftuar se jeni miratuar si student që do të përfitoni mbështetje financiare edhe për vitin akademik 2024-2025. (Bashkëlidhur emailin). Gjithashtu lista me studentët vijues të mbështetes financiare i janë përcjellë Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër në rrugë shkreore. Faleminderit,	Pergjigjia jepet e plote	Jo
11	26.02.2025	Faleminderit për përgjigjen dhe konfirmimin mbi miratimin e mbështetes financiare për vitin akademik 2024-2025. E vlerësoj shumë ndihmën dhe informacionin e dhënë. Megjithatë, pasi u interesova pranë Rektoratit të Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, më është komunikuar se emri im nuk figuron në listën e përfituesve. Për këtë arsye, doja të kërkoja një sqarim mbi situatën dhe nëse është e mundur të verifikohet përsëri statusi im në listën e dërguar universitetit. Ju lutem më njoftoni nëse është e nevojshme të ndjek ndonjë hap tjetër për të sqaruar këtë çështje. Faleminderit për kohën dhe bashkëpunimin.	03.03.2025	Përsërdetje, Në vijim të komunikimeve ju informoj se: Ju keni aplikuar pranë AKFAL për mbështetje financiare dhe keni nënshkruar marrëveshjen nr.61/3 prot.,datë 14.02.2024 si përfituese e mbështetes financiare në program studimi që përbën prioritet kombëtar për vitin akademik 2023-2024. Ju jeni miratuar si studente vijuese që përfitoni mbështetje financiare edhe për vitin akademik 2024-2025, pra ju përfitoni bursë në masën 40,000 lekë në muaj edhe për këtë vit akademik. Lista e studentëve vijues të mbështetes financiare edhe për vitin 2024-2025 i janë përcjellë Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër në rrugë shkreore. Faleminderit,	Pergjigjia jepet e plote	Jo

Nuk ka pasur kërkesa për informacion gjatë këtij muaji						
Nuk ka pasur kërkesa për informacion gjatë këtij muaji						
12	19.05.2025	Si jeni!Doja tju pyesja si eshte e mundur qe na eshte hequr bursa para 1 muaj pa asnje lloj lajmierimi pa thyer asnje rregull nga ajo qe ne firmosem.	22.05.2025	Përschendetje, Ju lutem dergoni te dhenat tuaja, emer mbiemer, programi I studimit dhe IAL ne te cilen ndiqni studimet, me qellim trajtimin e kerkeses tuaj. Faleminderit,	Pergjigia jepet e plote	Jo
13	19.05.2025	Pershendetje si jeni? Vajta sot ke financa per tu ankuar per arsyen e vonesave te burses, edhe me lajmieran se na eshte nderprer, nderkohe qe kontrata thot ngelja ne fund te vitit behet shkeputja e burses jo ne qofte se un kam 2-3 mungesa ne muajt se normal eshte ajo pune njerz jemi, na eshte ofruar nje burse per te mbuluar shpenzimet mujore se ndryshe se kemi mundesi te vazhdojme shkollen. Nderkohe kta e perdorin si kerencimin per ardhjen apo mos ardhjen ne shkollë, gjithsesi ne gifte se vazhdohet kshu do detyrohem i te nderpresim shkollen ju nga deshira jone po nga mungesa e fondit qe na eshte caktuar. Faleminderit Sent from my iPhone	22.05.2025	Përschendetje, Në përgjigje të emailit tuaj ju informojmë se: Ju keni nënshkruar marrëveshjen tre palëshe AKFAL- IAL-Student në datë 28.02.2025. Në nenin 4 të kësaj marrëveshje mbi të drejtat dhe detyrimet e përfutuesit përcaktohet se; "Përfutuesi, me qëllim vijimitin e financimit, për çdo vit akademik pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje duhet të ndjekë programin e studimit, që përbën prioritet kombëtar, të përcaktuar në nenin 2 të kësaj marrëveshje, si dhe të shtyjë të gjitha detyrimet akademike të vitit akademik përkatës". Sa më sipër ju duhet të interesoheni pranë IAL-së suaj për plotësimin e kritereve për përfitimin e mbështetjes financiare. Faleminderit	Pergjigia jepet e plote	Jo
14	16.06.2025	Pershendetje! Ndjese,por kisha nevoje per nje informacion mbi kontraten trepalleshe qe kam nenshkruar... Duke qene se une nuk jam me perfutuese e financimit sa rroga minimale baze ,qe prej ketij viti ,nese vendos ta nderpres kontratan ,qe IAL ne fund te me dorzojne diplomen origjinale, a duhet te kthej mbrapsht brenda 6 muajsh vetem shumen prej 360000 lekesh qe kam perfutuar vitin e pare te studimit?	19.06.2025	Përschendetje, Në mbështetje të VKM-së nr.386 datë 1.6.2022 "Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyev e studentëve, që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë", të ndryshuar, si dhe në zbatim të nenit 5 të marrëveshjes trepallesh të nënshkruar, ju bëjmë me dije se: Përfutuesi ka të drejtë të paraqesë kërkesë me shkrim, drejtuar dy palëve të tjera të marrëveshjes, për zgjidhjen e saj, duke qëndë i detyruar të kthejë 100% të përfitimit financiar të marrë deri në momentin e prishjes së marrëveshjes. Në rastin e zgjidhjes së marrëveshjes përfutuesi duhet të kthejë shumë në logarinë e IAL-së, që ka të zafundir të VKM-së nr.386 datë 1.6.2022, fitimismon, pada veç këti, shkronja cy suprenet se studentët tmer te kanget zyrtarisht diplomën/at origjinale përkatëse të arsimit të lartë, për të cilin përfiton financim, nga institucioni publik i arsimit të lartë ku ka përfunduar studimet tek institucioni apo subjekti juridik ku punësohet, deri në shlyerjen e detyrimeve, sipas marrëveshjes së parashikuar në këtë vendim".	Pergjigia jepet e plote	Jo
15	25.06.2025	Pershendetje, a mund te me tregoni se ku duhet te aplikoj, gjithashtu a duhet vetem ne sektorin publik apo edhe ne privat? Ku duhet te drejtohemi? A mund te me tregoni se ne cfare vendesh pune duhen aplikuar qe te jene i pershatshem per permubshjen e 3 vjecarit apo eshte cfaredo lloj pune? Faleminderit	25.06.2025	Gjithashtu, ne marreveshjen trepalleshe neni 4, pika 2, percakton se: Përfutuesi ka detyrimin të njoftojë ministrinë përgjegjesë për arsimin ose AKFAL-in, për çdo aplikim apo kërkesë për pusëmim të bërë, si dhe shkaqet e refuzimit. Në rastin e pusëmimit, përfutuesi ka detyrimin të njoftojë AKFAL-in, si dhe IAL-në për të dërguar vërtetim diplominë dhe listë notash të studentit përfutues, tek institucioni apo subjekti juridik ku punësohet, deri në blonim e detyrimeve ato kushton, ate se bashku e 2 qytetit, njehsi rremegfite" të hosi edhe 3 viteve. Pershendetje,	Pergjigia jepet e plote	Jo
16	25.07.2025	Pershendetje, jam XY studente viti i dyte bachelor dega Arsini Fillori u, perfutuese e burses si dege prioritare prej 40.000 lekesh. Deri me sot Kane kaluar vetem 6 muaj burse dhe mengojne edhe 3 muaj te tjere. Ju lutem a mund te kem me shume informacion per arsyen e kesaj vonese te tepruar! Diten e mire.	03.08.2025	Ne mbestetje me pikën 3 te nenit 6 te "Marreshjes per Perfittimin e Marreshjes Treपालेश" "IAL-ja ka për detyrë të konfirmoje frekuentimin e programit perkates te studimit nga perfutuesi dhe te kryete pageze ne logarine bankare te perfutiesit. Sa me siper, dhe ne vijim te komunikimeve me Universitetin "Luigi Gurakuqi", Shkoder, ju informojme se pagesat e mbestetjes financiare do te kalothen sapo te kene ne dispozicion frekuentimin tuaj ne programin "Arsini Fillori", per tre muajt, nga fakulteti perkates. Faleminderit,	Pergjigia jepet e plote	Jo
Nuk ka pasur kërkesa për informacion gjatë këtij muaji						

17	09.09.2025	Përshendetje, Duke qene se mesatarja e vitit të parë është 9.23, gjatë vitit të dytë nuk e përfitova bursën në masën 40.000 lekë. Meqë mesataren e vitit të dytë e kam 9.63, doja të dija nëse e përfitoj apo jo bursën në masën 40.000 lekë për vitin e tretë. Faleminderit.	10.09.2025	Përshëndetje, Në vijim të emailit të mëposhtëm, ju informojmë se zbatim të pikës 10 të Udhëzimit nr.30/2022, i ndryshuar, AKFAL do të kryej procesin e verifikimit mbi plotësimin e kriterëve sipas pikës 4 të VKM nr.386/2022 i ndryshuar, ku parashikohet se studenti përfitues i mbështetjes financiare si student i shkëlqyer me qëllim vijimin e përfundimit të financimit, duhet të ruajë notën mesatare jo më pak se 9.5 gjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve. Në përfundim të procesit do të njoftoheni. Faleminderit,	Pergjigjia jepet e plote	Jo
18	17.09.2025	I nderuar staf i Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë , Unë jam studente e diplomuar në degën Biologji pranë Universitetit të Vlorës. Në bazë të kontratës që kam firmosur për bursën e ekscelencës, dua të kërkoj një sqarim zyrtar: A është e detyrueshme, sipas kushteve të kontratës, që të aplikoj dhe të ndjek një program Master Profesional, apo kam të drejtë të zgjedh edhe program Master Shkencor? Duke qenë se dëshira ime është të vazhdoj Masterin Shkencor, do të doja të dija nëse kjo ndikon apo jo në përfitimin dhe vijimësinë e bursës sime, apo duhet ti rikthej të gjithë vlerën e pagës që kam marrë tre vitet e studimit bachelor. Ju falenderoj për kohën dhe bashkëpunimin dhe mbetem në pritje të përgjigjes suaj zyrtare.	17.09.2025	Përshëndetje, Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion ju bëjmë me dije se, sipas verifikimit të kryer nga AKFAL, Ju keni nënshkruar marrëveshjen tre-palëshe (AKFAL-IAL-Student) me nr. 30/8 prot., datë 15.02.2023, sipas pikës 3 gërma "c" të VKM nr.386/2022, si student që ndjekin studimet në programe prioritare. Me Vendimin nr.8 datë 08.09.2025, Bordi Drejtues i AKFAL ka miratuar modelin e marrëveshjes tre palëshe për studentët që ndjekin studimet e ciklit të dytë në një program prioritar, që kanë nënshkruar marrëevshjen në vitin akademik 2022-2023 dhe që plotësojnë kriteret sipas VKM nr.386/2022. Sipas nenit 75 të ligjit nr.80/2015, përcaktohet “Cikli i dytë i studimeve përfshin programet e studimit “Master i shkencave”, “Master i arteve” dhe “Master profesional”, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.” Në përfundim ju do të nënshkruani marrëveshjen për vijimin e financimit për ciklin e dytë të studimeve, sipas programit të studimit të përzgjedhur nga ana juaj, brenda fushës së studimit të programit Bachelor i konsideruar si program prioritar në vitin akademik 2022-2023, në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë.. Ju faleminderit,	Pergjigjia jepet e plote	Jo
19	12.09.2025	Te nderuar, Pershendetje, uroj te jeni mire. Ju shkruaj per te kerkuar informacion lidhur me ndjekjen e studimeve ne Bachelor te dyte dhe degët e percaktuara si me prioritet kombetar. Une kam perfunduar studimet Bachelor ne Kimi dhe gjithashtu edhe ciklin Master. Per shkak te angazhimeve aktuale, me ka lindur nevoja te ndjek nje Bachelor te dyte, p.sh. ne Kimi Industriale e Mjedisore ose ne Inxhinieri Kimike (Dege ne Fakultetine Shkencave te Natyres). Ne kete kuader, do te doja te dija: A jane deget Kimi Industriale e Mjedisore ose ne Inxhinieri Kimike dege me prioritet kombetar? A perfitohet bursa e percaktuar për degët me prioritet kombetar edhe ne rastin tim (Bachelor te dyte)? E mirepres odo informacion tjeter qe mund te me ndihmoje. Ju falenderoj paraprakisht per informacionin dhe ndihmen tuaj. Me respekt,	29.09.2025	Përshëndetje, në vijim të emailit tuaj ju informoj se: Në zbatim të VKM nr. 386/2022, i ndryshuar, pikës 3 “Mbështetjen financiare, vetëm për njërën nga kategoritë e përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi, e përfiton studenti për program të parë studimi”. Ju mund të ndiqni një program studimi , të dytë, por nuk përfitoni mbështetje financiare. Ju faminderit,	Pergjigjia jepet e plote	Jo
20	23.09.2025	Pershendetje ndjes per shqetesimin. Jam nje studente e cila studioj ne fakultetin e inxhinierise gjeologjike .Jam e pajisur me burs por per kete vit akoma s me ka ardhur same njoftim.Doja te pyesja kur vjen njoftimi per dekumentat e burses .	29.09.2025	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës suaj, ju bëjmë me dije se procedura për vijueshmërinë e mbështetjes financiare për vitin akademik 2025-2026 kryhet në zbatim të VKM nr. 386, datë 01.06.2022, i ndryshuar, “Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve” dhe Udhëzimit nr. 30, datë 04.11.2022, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për përcaktimin e rregullave dhe afateve të aplikimit, si dhe të procedurave të përcaktimit të masës dhe mënyrës së financimit të studentëve të shkëlqyer dhe atyre që ndjekin programe studimi që përbëjnë prioritet kombëtar”. Ju do të njoftoheni në kohë nga AKFAL për fillimin e procesit të vijueshmërisë së mbështetjes financiare.	Pergjigjia jepet e plote	Jo

21	23.09.2025	Kerkese: Jam studentja tek universiteti bujqesor i tiranes tek dega agrobiznes. Kam mare bursen e deges prioritare agrobiznes dhe me duhet nje kopje e kontrates se burses per tu regjistruar ne master. Faleminderit!	25.09.2025	Përsëhëndetje, Në vijim të kërkesës suaj, ju bëjmë me dije se për të tërhequr një kopje të kontratës së bursës, duhet të paraqiteni pranë zyrës së protokollit të Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë, së bashku me një dokument identifikimi. Faleminderit,	Pergjigjia jepet e plote	Jo
22	24.09.2025	Pershendetje, jam studente perfutuese e burses si dege prioritare, universiteti "Luigi Gurakuqi" Shkoder. Jam e interesuar te di dokumentacionin qe nevojitet per perfitimn e burses edhe per kete vit. Gjithashtu doja te dija datat e aplikimit edhe per ata qe aplikojne per here te pare se kam nje te aferm qe e perfiton. Ne prifte te pergjigjes tuaj, ju falenderoj!	29.09.2025	Pershendetje, Në vijim të kërkesës suaj për vijimin e mbështetjes financiare, ju bëjmë me dije se procedura për vijueshmërinë e Mbështetjes Financiare për vitin akademik 2025-2026 kryhet në zbatim të VKM nr. 386, datë 01.06.2022, i ndryshuar, “Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve” dhe Udhëzimit nr. 30, datë 04.11.2022, të Ministrit të Arsimit, “Për përcaktimin e rregullave dhe afateve të aplikimit, si dhe të procedurave të përcaktimit të masës dhe mënyrës së financimit të studentëve të shkëlqyer dhe atyre që ndjekin programe studimi që përbëjnë prioritet kombëtar”. Ju do të njoftoheni në kohë nga AKFAL për fillimin e procesit të vijueshmërisë së mbështetjes financiare. Përsa i përket pyetjes për studentët të cilët aplikojnë për herë të parë, ju bëjmë me dije se datat do të bëhen publike në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë.	Pergjigjia jepet e plote	Jo
23	24.09.2025	Pershendetje ndjes per shqetesimin. Jam nje studente e cila studioj ne fakultetin e inxhinerise gjeologjike .Jam e pajisur me burs por per kete vit akoma s me ka ardhur same njoftim.Doja te pyesja kur vjen njoftimi per dekumatat e burses .	29.09.2025	Përsëhëndetje, Në vijim të kërkesës suaj, ju bëjmë me dije se procedura për vijueshmërinë e mbështetjes financiare për vitin akademik 2025–2026 kryhet në zbatim të VKM nr. 386, datë 01.06.2022, i ndryshuar, “Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve” dhe Udhëzimit nr. 30, datë 04.11.2022, të Ministrit të Arsimit, “Për përcaktimin e rregullave dhe afateve të aplikimit, si dhe të procedurave të përcaktimit të masës dhe mënyrës së financimit të studentëve të shkëlqyer dhe atyre që ndjekin programe studimi që përbëjnë prioritet kombëtar”. Ju do të njoftoheni në kohë nga AKFAL për fillimin e procesit të vijueshmërisë së mbështetjes financiare.	Pergjigjia jepet e plote	Jo
24	26.09.2025	Pershendetje! Jam studente e vitit te 4 Stomatologji. Prej tre vitesh kam qene perfutuese e burses. Doja tju pyesja se kur do te dorezojme dokumentat e nevojshem per vertetim te ruajtjes se burses pasi nuk me ka ardhur asnje informacion akoma(duke qene se vitet e tjera ka ardhur brenda muajt shtator).	29.09.2025	Përsëhëndetje, Në vijim të kërkesës suaj, ju bëjmë me dije se procedura për vijueshmërinë e mbështetjes financiare për vitin akademik 2025–2026 kryhet në zbatim të VKM nr. 386, datë 01.06.2022, i ndryshuar, “Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve” dhe Udhëzimit nr. 30, datë 04.11.2022, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për përcaktimin e rregullave dhe afateve të aplikimit, si dhe të procedurave të përcaktimit të masës dhe mënyrës së financimit të studentëve të shkëlqyer dhe atyre që ndjekin programe studimi që përbëjnë prioritet kombëtar”. Ju do të njoftoheni në kohë nga AKFAL për fillimin e procesit të vijueshmërisë së mbështetjes financiare.	Pergjigjia jepet e plote	Jo
25	29.09.2025	Te nderuar, Pershendetje, uroj te jeni mire. Ju shkruaj per te kerkuar informacion lidhur me ndjekjen e studimeve ne Bachelor te dyte dhe degët e peracktuara si me prioritet kombetar. Une kam perfunduar studimet Bachelor ne Kimi dhe gjithashtu edhe ciklin Master. Per shkak te angazhimeve aktuale, me ka lindur nevoja te ndjek nje Bachelor te dyte, p.sh. ne Kimi Industriale e Mjedisore ose ne Inxhinieri Kimike (Dege ne Fakultetine Shkencave te Natyres). Ne kete kuader, do te doja te dija: A jane degët Kimi Industriale e Mjedisore ose ne Inxhinieri Kimike dege me prioritet kombetar? A perfitohet bursa e peracktuar për degët me prioritet kombetar edhe ne rastin tim (Bachelor te dyte)? E mirepres odo informacion tjetër qe mund te me ndihmoje. Ju falenderoj paraprakisht per informacionin dhe ndihmen tuaj. Me respekt,	29.09.2025	Përsëhëndetje, në vijim të emailit tuaj ju informoj se: Në zbatim të VKM nr. 386/2022, i ndryshuar, pikës 3 “Mbështetjen financiare, vetëm për njërën nga kategoritë e përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi, e përfiton studenti për program të parë studimi” . Ju mund të ndiqni një program studimi , të dytë, por nuk përfitoni mbështetje financiare. Ju fëminderit	Pergjigjia jepet e plote	Jo

26	01.10.2025	Pershendetje, jam studente ne vitin e pare universitetin e Mjekesise Tirane. Gjimmazin e kam mbaruar si nje nxenese ekselente. Degjova rreth burses suaj te ekselences ndaj po ju kontaktoj per te marre me shume informacion si funksionon dhe kush e perfiton. Faleminderit per kohen tuaj!	09.10.2025	Përsëndetje, Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 386, datë 01.06.2022, të ndryshuar, “Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e studentëve që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë”, pikës 2 Mbështetjen financiare nga buxheti i shtetit e përfitojnë studentet , që nuk janë njëkohësisht përfitues të ndonjë financimi tjetër nga shteti shqiptar dhe që plotësojnë kriteret e mëposhtme: Studenti me notë mesatare në pranim, që: - ka përfunduar arsimin e mesëm të lartë me notë mesatare 10.00; -në secilin prej provimeve kombëtare të detyruara të maturës shtetërore është vlerësuar me jo më pak se nota e shkallëzuar 9.5 deri në 10.00. Faleminderit, Pershendetja,	Pergjigjia jepet e plote	Jo
27	03.10.2025	Pershendetje ! Jam nje studente ne vitin e trete sivjet bachelor biologji , ne universitetin Ismail Qemali Vlore qe kam perfutuar bursen prioritare vitin e pare dhe te dyte. Jam e interesuar a do te hidhet bursa per studentet kete vit ? Pres pergjigjen tuaj , faleminderit!	09.10.2025	Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 386, datë 01.06.2022, të ndryshuar, “Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e studentëve që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë”; Udhëzimit nr. 30, datë 04.11.2022 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, të ndryshuar; Marrëveshjes trepalëshe të nënshkruar ndërmjet Studentëve, IAL-ve dhe AKFAL-it; Ju bëjmë me dije se për studentët që vijnë në të përfitojnë mbështetje financiare për vitin akademik 2025-2026, është e nevojshme të depozitoni pranë Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë dokumentacionin si më poshtë:	Pergjigjia jepet e plote	Jo
28	07.10.2025	Pershendetje, Une nje student i fakultetit te Historise dhe Filologjise, ne programin e Historise, viti III. Jam prej dy vitesh perfitues i burses per programet prioritare. Vitin e kaluar, afersisht ne kete kote, mu kerkua nga ju depozitimi i nje liste notash dhe nje vertetimi per shlyerjen e detyrimeve te vitit I, ne menyre qe te vazhdoja te perfitoja mbeshtetjen qeveritare. Pyetja ime lidhet me vitin aktual, perderisa nuk kam marre asnje njoftim ne lidhje me dokumente qe me duhet te dorozoj prane institucionit tuaj. Ju lutem te me informoni me proceduren qe duhet te ndjek ne menyre qe edhe per vitin aktual, te jem ne gjendje te vazhdoj te perfitoj mbeshtetjen nga qeveria per programet prioritare, sic parashikohet ne VKM nr. 386, datë 01.06.2022, “Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e studentëve, që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë”, të ndryshuar, të Udhëzimit nr.30, datë 04.11.2022 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për përcaktimin e rregullave dhe afateve të aplikimit, si dhe të procedurave të përcaktimit të masës dhe mënyrës së financimit të studentëve të shkëlqyer e studentëve, që ndjekin programe studimi që përbëjnë prioritet kombëtar”, të ndryshuar. Ku uroj pune te mbare.	09.10.2025	Përsëndetje Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 386, datë 01.06.2022, të ndryshuar, “Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e studentëve që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë”; Udhëzimit nr. 30, datë 04.11.2022 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, të ndryshuar; Marrëveshjes trepalëshe të nënshkruar ndërmjet Studentëve, IAL-ve dhe AKFAL-it; Ju bëjmë me dije se për studentët që vijnë në të përfitojnë mbështetje financiare për vitin akademik 2025-2026, është e nevojshme të depozitoni pranë Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë dokumentacionin si më poshtë: Listën e notave për vitin akademik 2024-2025; Vërtetimin për shlyerjen e të gjitha detyrimeve për vitin akademik 2024-2025. Në rast se nuk plotësohet kriteri i notës mesatare, studenti humbet të drejtën e përfitimit të mbështetjes financiare për vitin akademik pasardhës. Depozitimi i dokumentacionit duhet të kryhet në një nga mënyrat e mëposhtme: fizikisht pranë zyrave të AKFAL-it, në format elektronik, në adresën: adresën e e-mailit: enkelejda.meta@arsimi.gov.al në rrugë postare, në adresën: “Rruga Naim Frashëri, Nr. 34, Tiranë”, Afati i dorëzimit të dokumentacionit , brenda datës 24.10.2025. Faleminderit për bashkëpunimin.	Pergjigjia jepet e plote	Jo
29	08.10.2025	Doja edhe t’ju informoja që unë si studentë tashmë vazhdojmë masterin. Në bazë të një emaili nga AKFALbështetjen ne e përfitojmë edhe në ciklin e dytë, a duhet të dorëzoj vetëm notat e vitit 3?.	09.08.2025	I nderuar student, Po, ju përfitoni mbështetje financiare edhe për ciklin e dytë të studimeve (master), sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. Megjithatë, në përputhje me VKM nr. 386, datë 01.06.2022, pika 4, kriteri për vijimin e mbështetjes është që mesatarja e tre viteve të ciklit të parë të studimeve (Bachelor) të mos jetë më pak se 8.5. Prandaj, për të përfituar mbështetjen, ju duhet të dorëzoni mesataren e tre viteve të studimeve të ciklit të parë (Bachelor), e cila do të merret në shqyrtim për vlerësimin përfundimtar. Me respekt,	Pergjigjia jepet e plote	Jo

30	11.10.2025	Pershendetje jam student i matematikes viti 2.pyes ne lidhje me bursen prioritare a duhet te paraqes ndonje dokument ne vijim	13.10.2025	Përsëndetje Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 386, datë 01.06.2022, të ndryshuar, "Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e studentëve që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë"; Udhëzimit nr. 30, datë 04.11.2022 të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit, të ndryshuar; Marrëveshjes trepalëshe të nënshkruar ndërmjet Studentëve, IAL-ve dhe AKFAL-it; Ju bëjmë me dije se për studentët që vijojnë të përfitojnë mbështetje financiare për vitin akademik 2025-2026, është e nevojshme të depozitoni pranë Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë dokumentacionin si më poshtë: Listën e notave për vitin akademik 2024-2025; Vërtetimin për shlyerjen e të gjitha detyrimeve për vitin akademik 2024-2025 Në rast se nuk plotësohet kriteri i notës mesatare, studenti humbet të drejtën e përfitimit të mbështetjes financiare për vitin akademik pasardhës. Depozitimi i dokumentacionit duhet të kryhet në një nga mënyrat e mëposhtme: fizikisht pranë zyrave të AKFAL-it, në format elektronik, në adresën: adresën e e-mailit: anila.bozaxhiu@arsimi.gov.al në rrugë postare, në adresën: "Rruga Naim Frashëri, Nr. 37, Tiranë", Afati i dorëzimit të dokumentacionit , brenda datës 24.10.2025. Faleminderit për bashkëpunimin. Me respekt, Pershendetje	Pergjigjia jepet e plote	Jo
31	13.10.2025	Pershendetje! Jam nxenese e universitetit Fan.S.Noli ne qytetin e Korces dhe kam mbaurar vitin e dyte per arsim fillor dhe keto dy vite kam marre bursen e deges prioritare, deshiroj te dij nese duhet te dergoj ndonje liste notash dhe nje vertetim qe kam shlyer te gjitha detyrimet per vitin akademik 2024-2025 ne menyre qe te vazhdoj bursa dhe per kte vit te 3 ? Faleminderit	13.10.2025	Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 386, datë 01.06.2022, të ndryshuar, "Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e studentëve që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë"; Udhëzimit nr. 30, datë 04.11.2022 të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit, të ndryshuar; Marrëveshjes trepalëshe të nënshkruar ndërmjet Studentëve, IAL-ve dhe AKFAL-it; Ju bëjmë me dije se për studentët që vijojnë të përfitojnë mbështetje financiare për vitin akademik 2025-2026, është e nevojshme të depozitoni pranë Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë dokumentacionin si më poshtë:	Pergjigjia jepet e plote	Jo
32	20.10.2025	Përsëndetje, A përfiton bursë studimi për degën prioritare një student me mesatare 7.8 në degën e studimit "Gjuhë angleze" mësuesi në Universitetin "Ismael Qemali "Vlorë" ? Nëse po, të lutem mund të më orientoni më shumë rreth procedurave. Përgjigjia juaj do më ndihmonte shumë. Faleminderit!	21.10.2025	Përsëndetje, Në zbatim të Vendimit nr.7 datë 04.08.2025 të komisionit ad-hoc, për "Përcaktimin e programeve prioritare të studimit dhe kuotave të financimit për këto programe në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë për vitin akademik 2025-2026" ju informoj se: Programi i studimit " Mësuesi në Gjuhën Angleze" nuk bën pjesë në programet e studimit që përbëjnë prioritet kombëtar për vitin akademik 2025-2026. Ju faleminderit	Pergjigjia jepet e plote	Jo